# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-442147**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazh in grek \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/14/alket-rizai-duhej-te-kthehej-sot-ne-burg-por-u-zhduk-pas-te-shtenave-me-arme-si-ndodhi-sherri-ne-plazhin-grek/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 07:08:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 07:04:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `677ef58bad4477c27fa7bc9c929b0a7716db28900a71b687a8f9292b7a51844f` |
| TEKSTI | `faf2c810ec882b1b5c03d9cb9b5bc19bd78ed832babbc168d4d9c98045534543` |
| PAMJA | `6b095440d15e6e02a573a92d77728c2f57249488588e3ae9eeeb49caf02ab2bb` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `cb57857d6514e01b293a4f02efc5782f6ed28581fea4e1fa5f6ecfbd8ce7dc5a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/cb57857d6514e01b293a4f02efc5782f6ed28581fea4e1fa5f6ecfbd8ce7dc5a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek

09:04 : 14/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, RAJONI



Alket Rizai, shqiptari i njohur si ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i arratisur dy herë me helikopter nga burgu, është përfshirë në një incident me armë zjarri në një bar plazhi në Anavyssos të Athinës, në orët e para të mëngjesit.

Nga analiza e pamjeve filmike, të cilat policia arriti t'i shqyrtojë vonë pasdite, u konfirmua se një nga personat kryesorë të përfshirë në këtë ngjarje ishte pikërisht Alket Rizai, i cili ndodhej jashtë qelisë pasi kishte fituar leje nga Burgu i Domokos.

Kronologjia e ngjarjes nisi rreth orës 05:15 të mëngjesit, kur policia mori një njoftim për të shtëna me armë në vendngjarje. Kur efektivët mbërritën aty, nuk gjetën asnjë person, por vetëm dy gëzhoja dhe njolla gjaku.

Më vonë, autoritetet u njoftuan nga Qendra Shëndetësore e Kalivisë se për ndihmë mjekësore kishin mbërritur dy të plagosur: një 20-vjeçar grek me një plagë nga fragmentet e xhamit në kyçin e këmbës, dhe një 41-vjeçar pakistanez me një plagë plumbi në pulpë. Të dy rezultuan të ishin punonjës të biznesit, të cilët së bashku me pronarin dhanë dëshmi me versione të ndryshme për ngjarjen.

Sipas hetimeve, konflikti nisi kur pronari i lokalit uroi që të ulte muzikën pasi klientët kishin filluar të largoheshin. Në atë moment, Alket Rizai doli në parking dhe e vuri muzikën me volum të lartë në automjet. Pronari doli jashtë për t'i tërhequr vëmendjen nga frika e ndërhyrjes së policisë për zhurmën.

Lexo edhe:

Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai. Si ndodhi ngjarja

Sherr me thika në Athinë, përleshen 15 persona, mes tyre edhe shqiptarë

Debati degjeneroi në sherr, ku ndërhynë edhe persona të tjerë të stafit. Gjatë përplasjes, Rizai dyshohet se ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar në ajër, ndërsa më pas ka hapur zjarr edhe një shtetas afgan, që dyshohet si pjesë e sigurisë së lokalit, i cili gjithashtu është shpallur në kërkim. Si pasojë e të shtënave dhe rikoshetit të plumbave, mbetën të plagosur dy punonjësit

TË GJITHA


Dronët rusë sjellin luftën deri në Moldavi dhe Rumani
09:06 : 14/09/2026


Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, por u zhduk pas të shtënave me armë/ Si ndodhi sherri në plazhin grek
09:04 : 14/09/2026


Arsimi publik falas, por hyrja shtrenjtë! Sa kushton dita e parë e shkollës
08:57 : 14/09/2026


Roskovec/ Pas sherrit, një person plagos me çekiç babain e ish-bashkëjetueses
08:25 : 14/09/2026


Këmbimi valutor, 14 shtator/ Me sa blihen e shiten sot monedhat e huaja
08:20 : 14/09/2026


Parashikimi i motit për ditën e sotme, ja sa do të shkojnë temperaturat
08:09 : 14/09/2026



Horoskopi ditor, e Hënë 14 Shtator 2026
22:59 : 13/09/2026

... Si pasojë e të shtënave dhe rikoshetit të plumbave, mbeten të plagosur dy punonjësit e lokalit.

Pas ngjarjes, Alket Rizai dhe dy miqtë e tij u larguan me shpejtësi me makinë, ndërsa pronari i biznesit është arrestuar për dhënie të deklaratës së rreme.

Ngjarja ka vënë në lëvizje autoritetet greke, pasi pikërisht sot në mëngjes Alket Rizai kishte afatin e fundit për t'u kthyer në Burgun e Domokos, në të kundërt ai do të shpallet zyrtarisht i arratisur.

**Etiketa:** Alket Rizai | Greqi | te shtena me arme

## Lajme të lidhura



**Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dyshohet se është i përfshirë Alket Rizai. Si ndodhi ngjarja**

22:49 : 13/09/2026



**Sherr me thika në Athinë, përleshen 15 persona, mes tyre edhe shqiptarë**

14:25 : 13/09/2026



**Arratisja e Gentian Çipit në Greqi, gjendet i djegur automjeti i dytë që përdorën bashkëpunëtorët**

16:28 : 12/09/2026



**Arratisja e Gentian Çipit në Greqi, gjendet një prej mjeteve të bashkëpunëtorëve, dyshohet se u aksidentuan**

11:50 : 12/09/2026



**EMRI/ Ky është i burgosuri shqiptar që u arratis në Greqi, u ndihmua nga dy persona të kamufluar si policë**

10:18 : 12/09/2026



**Arratisje spektakolare në Greqi, i burgosuri shqiptar i ikën policisë gjatë transportit për në spital!**

08:54 : 12/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

NA NDIQ

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.